



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:067440
Datë: 08.12.2022
Numri i dokumentit: 03728863

C.nr.579/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Shyqri Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.Q. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. A.S. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "....." me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 4.500,00 euro, më datë 08 dhjetor 2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** së është tërhequr padia me numër C.nr.579/21, e paditësit Xh.Q. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. A.S. nga Prishtina, kundër të paditurës KS "....." me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e objektit të kontestit 4.500,00 euro.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Xh.Q. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. A.S. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 13.04.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "....." me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 4.500.00 euro.

I autorizuari i paditësit Av. A.S. me parashtresën e datës 07.12.2022, e ka njoftuar gjykatën se lidhur me këtë çështje juridike kontestuese, palët kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, andaj në bazë të mungesës së interesit juridik i kërkon gjykatës që padia C.nr.579/21, të konstatohet e tërhequr.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 457 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.579/21, me datë 08 dhjetor 2022

Gjyqtari:
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2021:067440
Datë: 08.12.2022
Numri i dokumentit: 03728863